

E rrëmbeu një person dhe u kërkoi familjarëve 30 mijë euro: Arrestohet një 23 vjeçar në Prishtinë



14/06/2024 22:07



Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar një 23 vjeçar të dyshuar për veprën penale rrëmbim.

Sipas policisë, ai e ka rrëmbyer një person dhe u ka kërkuar 30 mijë euro familjarëve të viktimës për ta liruar atë.

Gjatë aksionit tek i dyshuari janë gjetur dhe sekuestruar një armë, një thikë, 1 sopatë, një veturë dhe gjësende të tjera.

"Zyrtarët policor të Njësitit të Hetimeve të Përgjithshme të Prishtinës, në asistim të Njësitit për Reagim të Shpejtë, kanë arrestuar një person të dyshuar për veprën rrëmbim. Rasti është raportuar sot rreth orës 18:30, ku personi i dyshuar ka rrëmbyer një person, për lirim e të cilit nga familjarët e viktimës ka kërkuar një shumë parashë(30000 euro). Arrestimi i personit të dyshuar: Sh. K.mashkull, 23 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe lrimi i viktimës (në gjendje të mirë shëndetësore), është bërë pak minuta pas raportimit si rezultat i një pune intenzive hetimore, të cilën zyrtarët policor e kanë ndërmarrë në bashkëpunim me prokurorin e shtetit. Pjesë e aksionit policor ka qenë edhe bastisja dhe ekzaminimi i lokacionit ku është mbajtur viktimi, aty janë gjetë dhe sekuesteuar: -1 armë, -1 thikë, -1 sopatë si dhe gjësende të tjera. Po ashtu me vendim të prokurorit është konfiskuar edhe një veturë", thuhet në njoftim.

LAJME TË FUNDIT



Kurti në 81-vjetorin e lindjes së Ukshin Hotit:...



Rihanna pozon nudo




E veshur kuq e zi, Xhuli e 'kallë'...



Spanjë-Kroaci – Formacionet zyrtare

Më shumë nga uebi

nativeGRAM by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



Kurti në 81-vjetorin e lindjes së Ukshin Hotit: E jetonte atë...



Osmani në Zvicër takohet me presidenten e re të Maltës



Kurti: Shtetin që e gëzojmë ua kemi borxh dëshmorëve të UÇK-së



Varroset me nderime ushtarake nënoficeri i FSK-së që vdiq në vendin e punës



Beogradi s'i jep leje festivalit "Mirëdita – dobar dan", Shapiq: Prej...



Osmani prej Samiti për Ukrainën: Kosova, nga zero në model të...

Other Links